



TRAJNIM PËR MATORANTË

Trajnim për informimin e maturantëve të shkollave të mesme për përfitimin e bursave për studime universitare jashtë Kosovës.

(Ky material mund të shkarkohet falas nga nxënësit në dy këto faqe interneti: www.kosovain.eu, dhe www.nlcompany.eu, më tepër informata info@kosovain.eu dhe info@nlcompany.eu)

Përdorimi i këtij materiali për qëllime komerciale pa autorizim nga autorët është shkelje e pronës intelektuale.

Kryesuese e ekipit të ekspertëve që e kanë përgatitur këtë materie është **profesoresha Majlinda Mazelliu, ndërsa menaxher i projektit është Naim Gashi.**

Përdorimi i këtij materiali si kurikulë për shkollat e mesme është lejuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Prishtinë dhe Drejtoria Komunale e Arsimit në Mitrovicë.

Shkollimi jashtë Kosovës – përparësitë – sfidat – mundësitë

Hapi 1 - 20 minuta

Objektivi: Qëllimi i kësaj pjese të trajnimit është që të informohen nxënësit me përparësitë, sfidat dhe mundësitë e shkollimit jashtë vendit, në mënyrë që vendimi i tyre të jetë sa më objektiv dhe i duhur. Ky sesion do të shërbejë njëkohësisht për sensibilizimin e të rinjve si dhe ofrimin e informatave adekuate, të cilat në formën e materialeve mund t'i përcillen edhe familjeve të tyre nga vetë nxënësit, duke lehtësuar kështu mendimin objektiv të nxënësve dhe familjeve të tyre rreth mundësive të përfitimit të bursave dhe studimit jashtë Kosovës.

Përshkrimi i aktivitetit:

Informacion i përgjithshëm, për studimet jashtë Kosovës, prezantimi i SWOT- analizës rreth përparësive, sfidave, mundësive dhe rreziqeve për shkollimin jashtë vendit.

Të studiosh jashtë vendit – privilegj, dëshirë, nevojë apo mundësi?

Janë këto disa prej pyetjeve, që na vijnë në mend apo bëhen pjesë e diskutimeve të shumë të rinjve, gjatë bisedave të tyre, rreth shkollimit të Lartë Universitar, BA. Të studiosh jashtë apo në vend është **dilema e studimeve të larta**, e cila i shoqëron jo vetëm të rinjtë, por edhe familjet dhe institucionet qeveritare dhe joqeveritare në Kosovë, të cilat e shohin arsimimin e të rinjve si një çelës për zhvillimin dhe ndërtimin e Kosovës. Kosova e ka popullsinë më të re të Evropës, dhe mbi 60% e saj janë të rinj. Edukimi është një nga sektorët më të rëndësishëm për zhvillimin e Kosovës, sipas një raporti të Bankës Botërore për Kosovën, prandaj dhe zhvillimi i kapaciteteve dhe marrja e dijeve nga vendet më të zhvilluara është pjesë e strategjisë kosovare për zhvillimin e të rinjve.

SWOT-analiza:

Përparësitë dhe mundësitë - Përfitimet e mësimi jashtë vendit janë të shumta dhe shpesh tepër personale. Njerëzit zgjedhin të mësojnë jashtë vendit për arsye të ndryshme. Përparësitë kryesore janë: edukimi cilësor, njohuri profesionale të krahasueshme, ekspertizë dhe mundësi për qasje në punësim në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare, asset / pasuri për vendin si kuadro me dije të avancuar, njohje me kultura të tjera, mësimi i gjuhëve të reja, shkëmbim përvojash, idesh, krijimi i një përvojë profesionale, lidhja dhe krijimi i rrjeteve profesionale dhe shoqërore, mundësi të zhvillimit të karrierës, kthimi i dijes në vend, kontributi për rindërtimin e vendit, mundësi më të mëdha punësimi dhe shpërblimi në pagë. Të studiuarit jashtë të mundëson më shumë mundësi punësimi gjatë studimeve. Përgjithësisht universitetet në vendet e zhvilluara kanë shërbime të avancuara shtesë si p.sh klasa falas për mësimin e gjuhëve, transportin, udhëtime, punë praktike etj. Përparësitë e përgjithshme dhe arsyetimi që ka mbështetur zhvillimin e këtyre programeve për të financuar shkollimin e të rinjve jashtë vendit, ka qenë zhvillimi i administratës publike dhe, në veçanti, i personelit drejtues në qeveritë kosovare, duke krijuar kështu kasta profesionistësh dhe ekspertësh për rindërtimin dhe zhvillimin e vendit.

Dobësitë dhe rreziqet:

Edhe pse studimi jashtë vendit sjell përparësi dhe mundësi të panumërta, duhet të jemi të ndërgjegjshëm për disa gjëra. Njohja e Kosovës si shtet i pavarur, izolimi i qytetarëve të Kosovës duke aplikuar sistemin e vizave, mungesa e fondeve të mjaftueshme, përkrahje e dobët institucionale, vetëm 650, 130 euro janë alokuar për implementimin e Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë për vitin 2012, studimi në gjuhë të huaja, mungesa e institucioneve përkrahëse për përgatitjen e dokumentacionit dhe vizave, jeta jashtë familjes, përshtatja me kulturë dhe stil të ndryshëm jetese. Një rrezik që ekziston në financimin e studimeve jashtë vendit është rritja e fenomenit rrjedhja e trurit/brain drain, një fenomen ky mjaft i dëmshëm për zhvillimin e vendeve në tranzicion sikurse dhe Kosova.

Hapi 2 - 15 minuta :

Tema: Kush mund të përfitojë nga mundësia e bursave për shkollim jashtë

– kriteret / shkathtësitë ?

Objektivi: Nxënësit të informohen dhe vetëdijesohen për kriteret e pranimit dhe përfitimit të bursave për studime jashtë Kosovës, si dhe shkathtësitë e nevojshme. Gjithashtu, nxënësit do të informohen rreth mënyrës se si dhe ku të kërkojnë përkrahje për përmbushjen e kriterëve dhe nevojave siç janë testet e gjuhës, marrja e vizave etj.

Përshkrimi i aktivitetit:

(Prezantimi do të paraqesë kriteret e universiteteve dhe institucioneve joshkolllore donatore të bursave për nxënësit që mund të përfitojnë.

Ata do të informohen rreth kërkesave shtesë për përmbushjen e kriterëve siç janë ato gjuhësore dhe kërkesat administrative si dhe do të pajisen me adresa të sakta të institucioneve se ku mund të gjejnë përkrahje për përmbushjen e këtyre nevojave.)

Kriteret dhe shkathtësitë

Studimi jashtë vendit, duke përfituar një bursë studimi, është një proces i vështirë, që kërkon vullnet, punë, dedikim dhe performancë të shkëlqyeshme akademike. Procesi i kyçjes në përfitimin e bursave dhe

studimeve jashtë vendit është një proces që ka kërkesa specifike, në përcaktimin e kriterëve dhe përzgjedhjes së studentëve.

Ky proces ndahet në dy faza:

1. Faza e parë – përcaktimi i universitetit, degës së studimit dhe donatorit
2. Faza e dytë - aplikimi për bursë dhe aplikimi në universitet



Kriteret kryesore, të cilat janë të përbashkëta për të gjitha universitetet dhe donatorët, për përfitimin e bursave janë:

- Rezultate të shkëlqyeshme në shkollën e mesme;
- CV ku shihen interesat tuaja në aplikimin e dijes pas diplomimit/prioritetet;
- Shpesh herë duhet të intervistoheni ose të testoheni për kualifikim të bursave;
- Njohja e shkëlqyeshme e gjuhëve të huaja, kryesisht gjuha angleze ose në vartësi të shtetit ku aplikoni gjuhën vendase. Programet BA mbahen në gjuhën vendase.

Shënim i rëndësishëm:

Secili donator dhe universitet ka kriteret e veta, prandaj para përcaktimit për studime jashtë vendit, duhet të hulumtohen mire ueb-faqet apo të vizitohen zyrat për këshillim të këtyre institucioneve. Gjithmonë duhet të bazoheni në kriteret e publikuara nga donatorët dhe universitetet.

Shkathtësia gjuhësore: njohja e gjuhës së huaj (angleze apo ndonjë gjuhë tjetër që flitet në Bashkimin Evropian) është një domosdoshmëri për përfitimin e bursës dhe pranimin në universitetet ndërkombëtare, por niveli gjuhësor duhet të jetë i certifikuar dhe zakonisht universitetet përcaktojnë llojin e testit gjuhësor që kandidatët duhet të

kalojnë para pranimit në universitet, si p.sh: TOEFL, IELTS - sistemi ndërkombëtar për testimin e gjuhës angleze, etj.

Në Kosovë informacionin për përgatitjen dhe testin e gjuhës së huaj mund ta gjeni në New Age School, Rr. Agim Ramadani Nr. 30 Prishtinë www.newagechool.net , shkollë kjo e akredituar, për përgatitjen e studentëve dhe organizimin e testeve gjuhësore.

Marrja e vizave: për marrjen e vizave duhet të bashkëpunohet me ambasadat e vendeve përkatëse dhe ministrinë e jashtme të Kosovës. Një mundësi mjaft e mirë për marrjen e informatave të sakta dhe të nevojshme është adresa elektronike e Zyrës për Emigracionin e Rregullt IOM: www.migrant-service-centres.org; paketat informuese për shtetet, të cilat japin një informacion bazë mbi kërkesat që duhen plotësuar për të marrë vizë; kushtet që duhet të përmbushin punëtorët e huaj për të hyrë dhe qëndruar në vendet për të cilat janë të interesuar, mundësitë e studimit, lejet e punës dhe qëndrimit, bashkimin familjar, sistemet e sigurimit social dhe shëndetësor, mbështetjen ofruar emigrantëve dhe informacione të tjera.

Ju duhet të keni programin Adobe Reader për të hapur udhëzuesit. Për të hapur variantin falas në këtë adresë <http://get.adobe.com/reader/>

Zyra apo agjenci që mund t'ju ndihmojnë në Kosovë:

<http://aidkosovaalbanian.webs.com/nakontakttoni.htm> - shërbim elektronik

<http://aidkosovaalbanian.webs.com/studimedhebursa.htm> - shërbim elektronik

<http://www.masht.gov.net/advCms/#id=1223> – Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

Hapi 3 - 20 minuta:

Tema: Si t'i qasemi mundësive për bursa? Hulumtimi i mundësive dhe aplikimi.

Përshkrimi i aktivitetit:

Nxënësit do të trajtohen se si të identifikojnë mundësitë për përfitimin e bursave për shkollim jashtë Kosovës dhe si t'i qasen këtyre

mundësive. Gjithashtu do të instruktohen se si të aplikojnë për këto bursa dhe do të prezantohet një formë aplikimi, si model. Do të paraqitet materiali nga intervistimi i një roli-model/ student që ka përfituar burse dhe ka studiuar jashtë Kosovës.

Objektivi: Informimi dhe prezantimi i mënyrave praktike se si të hulumtohen mundësitë për përfitimin e bursave për studime jashtë Kosovës. Nxënësit të kuptojnë mënyrën e qasjes në këto mundësi, mënyrës së aplikimit, me qëllim të arrijnë dhe të përmbushin objektivin e tyre.

Procesi i identifikimit të mundësive, kërkimit dhe gjetjes së bursave.

Bëhuni serioz rreth kërkimit

Filloni kërkimin së paku dy muaj përpara se të bëni aplikimin. Kjo do t'ju japi kohën e mjaftueshme për të bërë një kërkim të hollësishëm, për të marrë sa më shumë informacione të detajuara dhe për të bërë zgjedhjen të cilën ju e dëshironi.

Për secilën bursë qoftë, sigurohuni nëse mund të aplikoni duke e ekzaminuar mirë atë.

Ju duhet doemos t'i plotësoni të gjitha informacionet të cilat kërkohen në aplikim dhe t'i dërgoni të gjitha dokumentet e nevojshme.

Duhet theksuar vazhdimisht se është e nevojshme të respektoni afatet përfundimtare sepse aplikimet të cilat dërgohen pas afatit përfundimtar nuk merren parasysh.

Pasi të keni përfunduar të gjitha kërkesat për aplikim, sugjerohet që të bëni një kopje të aplikimit dhe ta mbani për vete.

Ju mundeni të kontaktoni edhe vetë organizatën apo institucionin i cili e jep bursën.

Studentët e Ballkanit perëndimor të cilët duan të marrin pjesë në mobilitetin (lëvizje nga një universitet në tjetrin) në BE:

- Për të gjitha Target grupet: duhet të kenë kombësinë e njërit prej shteteve të Ballkanit perëndimor të cilët janë partnerë në projekt dhe kanë njohuri të mjaftueshme të gjuhës së mësimdhënies;
- Për studentët bachelor: duhet të kenë përfunduar me sukses shkollën e mesme; Ata do të duhet të argumentojnë si kjo periudhë e studimit jashtë do të jetë e dobishme për to (dhe rrethin e tyre socio-ekonomik) dhe të përfshijnë letrat mbështetëse në aplikimet e tyre individuale;

Për Target grupin 3: kandidatët duhet të jenë pjesë e grupeve të marginalizuara (vizitoni linkun për më tepër detaje rreth target grupeve <http://www.basileus.ugent.be/index.asp?p=101&a=98>)

Procesi i aplikimit bëhet i gjithi online dhe format e aplikimit janë në dispozicion në linkun

<http://www.basileus.ugent.be/index.asp?p=108&a=96> . Ju lutemi lexoni me kujdes të gjithë web faqen dhe sigurohuni se po aplikoni duke shfrytëzuar formën korrekte. Pasi të keni klikuar në linkun e duhur, do të vazhdoni në faqen për përcaktimin e akountit tuaj. Porsa të keni një llogari/account, nuk është e nevojshme t'i plotësoni të gjitha fushat, e as t'i ngarkoni të gjitha dokumentet përnjëherë: do të keni mundësi t'i ruani të dhënat dhe të vazhdoni më vonë. Pasi të keni plotësuar të gjitha fushat, një buton do të paraqitet për t'ju lejuar juve që edhe formalisht ta dërgoni aplikimin. Nëse butoni nuk paraqitet, kjo domethënë se ju keni harruar të plotësoni ndonjë fushë. Ju lutemi kontrolloni me kujdes formën tuaj të aplikimit.

Nëse e keni dërguar aplikimin tuaj, do të pranoni një e-mail automatik në adresën të cilën ju vetë e keni dhënë. Ky e-mail do të përmbajë aplikimin tuaj në format PDF dhe një numër tuaj të regjistrimit. Ju lutemi ruajeni këtë e-mail.

Në Kosovë procesi i aplikimit për studime jashtë vendit ka qenë i orientuar kundrejt bursave të ndryshme të studimit, të ofruara nga fondacionet, ambasadat apo organizatat e huaja, fondet qeveritare si dhe më pak ato personale. Fondacionet që kanë dhënë më së shumti bursa në Kosovë janë: fondacioni "Soros" me anë të skemave të bashkëpunimit me Universitetin e Evropës Qendrore (Central European University) në Hungari dhe me një rrjet të gjerë universitetesh në Angli e SHBA; programet e bursave të ofruara nga ambasadat e shteteve si SHBA (programet Fulbright, Ron Brown, Humphrey, American Councils); Mbretëria e Bashkuar (Chevening); Gjermani (DAAD); Itali, Holandë, Belgjikë, Francë, Turqi etj.

Procesi i kërkimit dhe i aplikimit për këto lloj bursash ka qenë dhe është relativisht i thjeshtë. Mjafton që të përcillen rregullisht mjetet e informimit (gazetat, media elektronike dhe gazetatat online), panairët e edukimit, njoftimet përkatëse, dhe të ndiqen me përpikëri udhëzimet për aplikim.

Bursat e studimit për nivelin bachelor janë të plota, pra mbulojnë të gjitha shpenzimet që pritet të ketë një student.

Përveç këtyre bursave, të cilat kanë një lidhje të brendshme me zhvillimet në Kosovë, shumë universitete kanë programet e veta të bursave. Tanimë në shumë universitete evropiane ka filluar procesi i hapjes dhe konsolidimit të studimeve në nivelin bachelor për studentët nga vendet e Ballkanit Perëndimor.

Rezultatet e shkëlqyera në këto lloj provimesh të shoqëruara me ese të shkruara mirë e qartë, janë një mundësi shumë e mirë për të marrë bursat që ofrohen nga vetë universitetet.

Për sa i takon bursave në nivelin universitar procesi i aplikimit për bursë ka dy modele. Njëri model lidhet me bursat e pjeshme të studimeve që ofron vetë institucioni akademik. Kuptohet që rezultatet e shkëlqyera në provimet e gjuhës dhe ato kualifikuese janë shumë të rëndësishme si edhe mesatarja sa më e lartë në studimet në shkollën e mesme. Ndryshe nga niveli pasuniversitar, provimet kualifikuese për universitetet amerikane janë në dy nivele. SAT (Standart Achievement Test) dhe SAT i specializuar. Provimi i parë teston njohuritë e kandidatëve në gjuhën angleze, njohuritë matematike dhe përpunimin logjik të materialeve. SAT-et e specializuar kanë të bëjnë me testimin e njohurive në fusha specifike, veçanërisht në fizikë, kimi, biologji etj. Pra, nëse studenti pretendon të kualifikohet për bursa, rezultatet e larta në këto provime përbëjnë një domosdoshmëri. Këto lloj bursash njihen edhe si bursa të meritës (merit base scholarships).

Lloji i dytë i bursave ka të bëjë me bursa të ngjashme me ato që ofrohen nga organizatat shtetërore që përmendëm më lart. Ato janë më të pakta në numër dhe në Kosovë rekordin e ka mbajtur fondacioni "Soros". Përveç këtij tipi burse, i cili është edhe ky në fakt i bazuar në intervistim dhe rezultate të shkëlqyera, ka bursa private, të cilat jepen kryesisht nga fondacione fetare për universitete me mbështetje nga institucionet fetare.

Në universitet evropiane, që janë zakonisht shtetërore, bursat jepen në bazë të marrëveshjeve që ekzistojnë mes ministrive të arsimit dhe marrëveshjeve universitare. Po ashtu, programet e mobilitetit të studentëve (ERASMUS, TEMPUS etj.) janë një formë tjetër e bursave që jepen për të ndjekur studimet për një kohë të paracaktuar në bazë të marrëveshjeve të shkëmbimit që ekzistojnë mes institucioneve akademike shqiptare dhe evropiane. Në këto raste rekomandimet e profesorëve apo dekanëve të fakulteteve shqiptare luajnë një rol parësor.

Zakonisht në faqet në internet apo në kohën kur studenti kualifikohet për të ndjekur studimet, institucioni akademik i sjell informacion në lidhje me programet e ndryshme të bursave që ofrohen. Edhe njëherë bashkëpunimi dhe mbajtja e hapur e kanaleve të komunikimit me këshilltarët akademikë dhe me personelin që merret me regjistrimin është shumë i rëndësishëm. Duhet theksuar megjithatë, që, nëse një

student apo studente ka rezultate të shkëlqyera dhe arrin ta demonstrojë këtë shkëlqim, universitetet bëjnë të pamundurën për ta bërë këtë individ pjesë të universitetit të tyre.

Aplikimi për vizë në ambasada

Sikur i gjithë procesi për aplikim të ketë qenë i suksesshëm dhe ju të keni marrë të gjithë dokumentacionin e duhur, përfshi edhe mbështetjen financiare apo bursat që ju lejojnë vazhdimin e studimeve, gjithçka mund të priset nga intervista juaj pranë ambasadës së shtetit ku ju po aplikoni për të ndjekur studimet. Ky proces ndryshon nga vendi në vend. Disa vende si Italia apo Franca e kanë të liberalizuar procesin për marrjen e vizave studentore, kurse vendet e tjera sa vijjnë dhe e bëjnë më të ngurtë këtë proces. Kuptohet që frika nga terrorizmi dhe veçanërisht ideja se grupi i studentëve me vulnerabilitetin dhe naivitetin që e karakterizon, mund të bëhen pre e këtyre grupeve, i detyron stafet konsullore që të shtojnë nivelet e kontrollit, duke mos u mjaftuar vetëm në kontrollin e dokumentacionit financiar dhe vërtetimin e origjinalitetit të ftesës apo dokumentacionit të regjistrimit të ardhur nga universiteti. Në fakt, e ndihmon shumë procesin tuaj të aplikimit për vizë një letër e shkruar nga zyra ndërkombëtare e universitetit ku ju keni aplikuar në të cilën ato i kërkojnë ambasadës apo zyrës konsullore mbështetje për aplikimin tuaj për vizë. Kjo intervistë është më shumë se çdo gjë tjetër një test psikologjik. Ju duhet të tregoni gjatë intervistës se do të ktheheni në Kosovë pas mbarimit të studimeve dhe do të duhet të punoni për Kosovën. Kjo mund të duket qesharake për disa, por duhet kuptuar se shumica e bursave, siç e theksova edhe më lart, janë të lidhura me zhvillimin e Kosovës dhe kontributin që ata që fitojnë këto bursa, do të japin në këtë proces zhvillimor. Nëse ka dyshim që ju do t'i bashkëngjiteni klasës së imigrantëve, qofshin edhe ata të ligjshëm, marrja e vizës studentore rrezikohet shumë. Nuk kanë qenë të pakta rastet, kur studentët edhe pse i kanë plotësuar të gjitha kushtet dhe kanë qenë të pranuar për të studiuar në universitet, nuk e kanë marrë vizën studentore, sepse nuk kanë qenë në gjendje të vërtetojnë kthimin e tyre në atdhe. Është e domosdoshme që në procesin e intervistimit të mos ketë asnjë fije dyshimi për qëllimin e kryerjes së studimeve. Shpesh studimet përdoren si trampolinë për t'iu shtuar radhës së imigrantëve dhe kur kjo ndodh rritet edhe më shumë vështirësia për të marrë vizë. Të qenit të sigurt në qëllimet tuaja, lidhja e ardhmërisë së tyre me zhvillimin e vendit, si edhe vërtetësia e dokumentacionit që paraqitni janë parakushte që ju sigurojnë sukses në intervistimin për vizë. Mungesa e këtyre parakushteve dhe mungesa e sinqeritetit në intervistë, jo vetëm që ju vë një njollë të

zezë për aplikimet e ardhshme që mund të bëni, por njëkohësisht i prish punë edhe aplikantëve të tjerë seriozë dhe të dedikuar për studime dhe për përmirësimin e së ardhmes së vendit të tyre.

Kalendari i përgjithshëm për aplikim

Muaji dhe hapat që duhen ndërmarrë

Shtator → Përcakto fushën e studimit dhe shiko në gazeta për aplikime të mundshme

Tetor → Kërko në internet informacion për universitetin/universitetet e përzgjedhura (deri në 5) dhe dërgon kërkesën për paketën e aplikimit

Nëntor → Bën përgatitjet përfundimtare për provimin e gjuhës. Regjistrimi për këtë provim, zakonisht duhet bërë që në gusht. Jepet provimi i gjuhës dhe sigurohesh pranë institucionit që kryen testimin gjuhësor që universitetet të cilat ke aplikuar marrin një kopje të rezultatit

Dhjetor → Fillon me procesin e plotësimit të formularëve të regjistrimit dhe siguron edhe referencat apo rekomandimet përkatëse. Është koha për të dhënë edhe provimet specifike, që kanë të bëjnë me degën e veçantë të studimeve

Janar - Shkurt → Sapo rezultatet nga provimet arrijnë, ato dërgohen së bashku me aplikimet e plotësuara pranë institucionit ku keni aplikuar. Fillon edhe procesi i aplikimit për bursa jashtë universitetit

Mars → Zakonisht është koha kur merren vendimet për sa i takon pranimit të studentëve në universitet. Nëse nuk jeni pranuar me bursë të plotë, është koha për të filluar procesin e aplikimit për bursa

Prill → Maj → Vazhdohet me procesin e aplikimit për bursa dhe mbahen kontaktet e mira me universitetin/universitetet e zgjedhura. Arrijnë dokumentet përfundimtare që ju garantojnë aplikimin për vizë

Qershor → Arrijnë konfirmimet bankare që keni marrë bursa për të mbuluar shpenzimet tuaja

Korrik → Gusht → Aplikohet për vizë. Bëhet nisja për në vendin ku do të studioni

Bibliografi: një pjesë e materialit është marrë nga një punim i prof Bernard Zeneli, në vitet akademike 2002 - 2005 ka qenë shef i Departamentit të Shkencave Politike dhe Administratës Publike të Universitetit të Prishtinës. Ai ka marrë pjesë në shumë borde përzgjedhëse dhe intervistuese të studentëve që aplikojnë për bursa si në Kosovë, Shqipëri dhe jashtë saj. Aktualisht, ligjëron lëndën e Teorisë së Marrëdhënieve Ndërkombëtare pranë Shkollës Pasuniversitare të Studimeve Evropiane të Universitetit të Tiranës.

Shembull: Fondacionet për bursa në Suedi i ndihmojnë nxënësit e vendeve në zhvillim, për të promovuar talente dhe profesionistë që do të kontribuojnë në zhvillimin dhe ndërtimin e vendeve të tyre. Suedia në klasën e saj intelektuale ka intelektualë dhe shkollarë nga e gjithë bota. Fondacionet kryesore për ofrimin e bursave në Suedi janë:

1. Erasmus Mundus Project Scholarships
2. Swedish Institute Scholarship Program
3. Bilateral Scholarship Program of Sweden
4. Non-Swedish Institute Scholarship Programs

Euruni – Formë Aplikimi për pranim në Universitet





Find us in our social networks:



Undergraduate / Bachelor Application Form

An asterisk () indicates information must be supplied for the form to be accepted*

European University Barcelona Campus

Year of Entry *

I am applying for *

Personal Information

Family name*

First name*

Sex*

Date of birth (D/M/Y)*

Place of birth*

Nationality*

Marital status*

Passport/ID Number

Mailing Address

Street, number*

City and State/Province*

Country*

Zip/Postal code*

Phone*

Mobile

Fax

E-mail*

Permanent Home Address (if different from above)

Street, number

City

Country

Zip/Postal code

Phone

Mobile

Fax

E-mail

Education

High school studies

High school

City

Country

Contact person

Diploma obtained

Dates attended

Undergraduate studies already attended

University

City

Country

Contact person

Degree obtained

Major

Dates attended

Grade Point Average

Tests :

Please indicate the date(s) and the score(s) of the test(s) taken.

TOEFL

IELTS

CAE

Languages:

Indicate your competency if applicable

	Native	Fluent	Good	Basic
English	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
French	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
German	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Italian	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Spanish	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Other (specify)

Honors received:

Please list any academic, professional, sporting or community awards (year, award, etc.)

Extra-Curricular Activities:

Sports, hobbies, politics, voluntary activities, etc. (dates, organization, activity, etc.)

Previous Work experience (starting with the most recent)

Job 1

Employer	<input type="text"/>
Location	<input type="text"/>
Dates	<input type="text"/>
Job title	<input type="text"/>
Full-time/Part-time	<input type="text"/>

Job 2

Employer	<input type="text"/>
Location	<input type="text"/>
Dates	<input type="text"/>
Job title	<input type="text"/>
Full-time/Part-time	<input type="text"/>

What are your career and long-term objectives?

(please limit your answer to 50 words)

Other Information

How did you first learn about European University programs?

Fair or exhibition	Which one?	<input type="text"/>
Educational Guide	Which Guide?	<input type="text"/>
Printed media	Which article/newspaper?	<input type="text"/>
Advertising in the press	Which newspaper/magazine?	<input type="text"/>
Recommendation from a former student?	Name :	<input type="text"/>
Internet	Which website/search engine?	<input type="text"/>

Social Network	Which one?	<input type="text"/>
Admission office	please specify the country :	<input type="text"/>
Educational agency	Which one?	<input type="text"/>
Other	please specify :	<input type="text"/>

Which search engine / directory did you use to find this site? If you found us through a search engine what was your query?

Essay

Write an essay or record a 1-2 minute video essay* to be included in your application package that will help the EU Admissions Committee become acquainted with you, understand your motivation to attend EU, and determine how well you can express yourself. The essay should be on one of the following topics:

1. Tell us about the most challenging team experience you have had to date. What role did you play? What did you learn?
2. Please comment on a personal failure that had an impact on your life and what you learned from it.
3. What achievement are you most proud of (studies, sports, professional life, etc.)?
4. If you could imagine an entirely different life from the one you lead, what would you want to be or do?
5. Each of us has been influenced by people, events, and situations in our lives. How have such influences shaped who you are today?

*To submit your video essay, please follow this link, upload it and forward the URL (http address) by email to the campus of your choice.

I will send these documents by post:

- Copy of degree(s) (diploma and grades)
- Two reference letters
- One Essay
- Three passport photos
- Copy of passport or ID card
- Bank certificate (certifying solvency)

- Application fee of 200 Euros

Certification

* I certify that the information provided in this application form is complete and factually correct. I understand that all required credentials must be submitted before an admission decision can be made. I accept complete responsibility for requesting that the official transcripts and educational records be sent to the Admission Office. I understand that all application documents submitted are the property of the European University and cannot be returned or reproduced. I also agree to abide by the rules and regulations of the European University.

[Send application form](#)

Thank you for taking the time to complete this form. Any problems with this form, please contact info.bcn@euruni.edu



European University - The Business School in Barcelona

Ganduxer 70, 08021 Barcelona, Spain

Tel. +34 93 201 81 71, Fax. +34 93 201 79 35 -

info.bcn@euruni.edu

Hapi 4 - 20 minuta :

Tema: Institucionet shkollore dhe joshkollore që ofrojnë bursa shkollimi për shtetas të huaj.

Objektivi: Nxënësit të informohen me listën e institucioneve qofshin ato universitare, ministri apo fondacione të ndryshme, të cilat ofrojnë bursa studimi për studentët e Kosovës, si brenda ashtu dhe jashtë saj.

Përshkrimi i aktivitetit:

Nxënësve do t'ju paraqitet lista e universiteteve ndërkombëtare që ofrojnë bursa për studentet nga Kosova si dhe lidhja se ku mund ta gjejnë këtë listë në mënyrë periodike, lista e institucioneve të tjera përkrahëse për bursa qofshin ato qeveritare dhe joqeveritare në Kosovë apo jashtë si dhe lidhjet se ku mund të gjendet në mënyrë periodike kjo listë.

Dëshiron të studiosh jashtë, vendos dhe shfrytëzoji mundësitë!

Duhet theksuar edhe një herë se ju duhet të lexoni me kujdes të gjithë

manualin për aplikim. Kjo do të thotë se duhet të siguroheni se i kuptoni të gjitha hapat dhe kërkesat e parashtruara. Një mënyrë shumë e lehtë për të vendosur aplikimin tuaj në këndin e aplikimeve të „refuzuara“ është mosrespektimi i të gjitha udhëzimeve. Pasi të keni shqyrtuar njëherë manualin, do të kishte qenë e dobishme që një mik, këshilltar apo anëtar i familjes të shqyrtonte atë edhe njëherë. Mbani mend se vetëm aplikimet e plota do t'i dorëzohen komitetit për dhënien e bursave. Burimet më të rëndësishme për kërkim të bursave janë Interneti dhe sigurisht Zyra për Marrëdhëniet Ndërkombëtare. Panifikoni të kaloni një kohë të mirë duke kërkuar nëpër web faqe të besueshme. Ky manual sigurisht që është i dobishme në këtë proces, por ama ju duhet të keni dëshirë për të kaluar shumë kohë duke kërkuar mundësitë e shumta të studimeve jashtë shtetit dhe marrjes së bursave të cilat janë në dispozicion.

Për shembull, web faqja www.study-in-europe.info ka një bazë të të dhënave të universiteteve evropiane të cilët janë të hapur për studentët e huaj.

Pra, hulumtoni të gjitha mundësitë në Kosovë dhe jashtë saj, për të përmbushur qëllimin tuaj. Më poshtë keni një sërë adresash institucionesh ku mund të gjeni bursa dhe të aplikoni për studime jashtë Kosovës.

Adresa ku mund te aplikoni për bursa dhe studime për vitin akademik 2012 – 2013:

MARRËVESHJET INSTITUCIONALE

Asociacioni i Universitetit Evropian

<http://www.eua.be/Home.aspx>

Procesi i Bolonjës

http://ec.europa.eu/education/higher-education/doc1290_en.htm

Programi Tempus

http://ec.europa.eu/education/external-relation-programmes/doc70_en.htm

Universiteti i Prishtinës www.uni-pr.edu

MiReKoc Shkolla Ndërkombëtare Verore, 2012, Turqi

Data e fundit për aplikim: 1 prill 2012

E hapur për: aplikues nga e gjithë bota

Vendi: korrik 1-13, 2012, Stamboll, Turqi

Shpërblimi: 5 bursa për kandidatë nga Evropa qendrore dhe lindore, bursa tjera të pjeshme do të jepen në bazë të meritës

Për më shumë informata ju lutem vizitoni: <http://miss.ku.edu.tr/home>

Fondi Anne Van Den Ban

Data e fundit për aplikim: e panjohur

Mund të aplikojnë: studentë premtues nga shtetet në zhvillim si dhe nga shtetet e

Evropës lindore dhe të mesme

Bursa: e pacaktuar

Për më shumë informata, ju lutem vizitoni:

<http://www.fondsen.wur.nl/UK/AvdB+scholarship+fund/About+AvdBan+Fund/>

Kolegji Colby-Sawyer, SHBA

Bursa për student ndërkombëtar.

Për më shumë informata vizitoni:

<http://www.colby-sawyer.edu/admissions/international/finaid.html>

Data e fundit për aplikim: e panjohur.

Quota Scheme per Studime ne Norvegji

Fonde për rreth 1100 studentë, ku 800 duhet të jenë prej shteteve në zhvillim nga Jugu dhe 300 prej Evropës qendrore dhe lindore si dhe Azisë qendrore, që të studiojnë në Universitetet e Norvegjisë.

Data e fundit për aplikim: e panjohur.

Për më shumë informata, vizitoni: <http://siu.no/en/Programme-overview/Quota-Scheme>

Universiteti i Edinburgh Coca-Cola Bursat

Data e fundit për aplikim: 2 prill 2012

E hapur për: Aplikantë për studime të nivelit universitar nga vende të zgjedhura

Bursa: Shpenzimet e shkollimit dhe bursë shtesë prej £5,000

Për më shumë informata ju lutem vizitoni: <http://www.ed.ac.uk/schools-departments/student-funding/undergraduate/international/coca-cola>

Universiteti Anglo-American Pragë ofron bursa për studime universitare dhe post-diplomike

Data e fundit për aplikim: në vazhdim

E hapur për: Të gjithë studentët e suksesshëm të interesuar

Bursa: dallon

Për më shumë informata ju lutem vizitoni: <http://www.aauni.edu/>

Programi i bursës Ahold Erasmus University Rotterdam, Holandë

Calum Miller Bursa 2012, Britani e Madhe

Data e fundit për aplikim: 31 maj 2012

E hapur për: Studentë nga çdo vend me sukses të mirë akademik

Bursa: Një bursë prej £10,00

Për më shumë informata ju lutem vizitoni: <http://www.ed.ac.uk/schools-departments/student-funding/postgraduate/uk-eu/humanities/business/miller>

Shkolla Evropiane e Manaxhmentit dhe Teknologjisë – Bursa

Data e fundit për aplikim: jo e specifikuar

Mund të aplikojnë: Kandidatët nga e gjithë bota me aftësi të mira udhëheqjeje Bursa:

Deri në 28,750 Euro

Për më shumë informata, ju lutem vizitoni: <http://www.esmt.org/>

http://www.usa.siemens.com/en/about_us/corporate_responsibility/foundation.htm?stc=usccc021731

Faqja e internetit e BE-së për bursa për Ballkanin Perëndimor:

<http://www.s4wb.eu/>

PUNA DHE PRAKTIKA

Roman grafike - W. G. Sebald në Prishtinë

Kur: 5 Maj / 11 Maj 2012.

Afati: 25 mars 2012 (Paraqitjet mund të bëhen ose online ose duke dërguar një CD-ROM /punime në letër.

Ju lutem respektoni formatin JPG me rezolucion prej 300 dpi për veprat pamore / grafik).

Për më shumë informacion ju lutem konsultoni: www.tiranaartlab.org

Praktikë në Qendrën Veri-Jug të Këshillit të Evropës

Data e fundit për aplikim: 15 prill 2012

Për më shumë informata ju lutem vizitoni:

http://www.coe.int/t/dg4/nscentre/traineeship_en.asp

GARA

Vienna Çmimet për Fotografi Ndërkombëtare VIPA 2012

Data e fundit për aplikim: 30 prill 2012

Për më shumë informata ju lutem vizitoni:

http://thevipawards.com/wordpress/?page_id=514

LISTA E DISA PREJ UNIVERSITETEVE KU MUND TË STUDIONI

SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS/ SHBA

<http://www.utexas.edu/world/univ/state/>

<http://www.collegeboard.com/student/index.html?student>

<http://www.educationusa.info/students.php>

<http://www.petersons.com/educationusa.aspx>

[http://colleges.usnews.rankingsandreviews.com/best-](http://colleges.usnews.rankingsandreviews.com/best-colleges)

[collegeshttp://www.princetonreview](http://www.princetonreview)

LISTA E UNIVERSITETVE NË MRETËRINË E BASHKUAR

Study in the UK

<http://www.studyoverseas.com/>

DISA QENDRA TË SHQUARA UNIVERZITARE NË EVROPË

Central European University in Budapest

<http://www.ceu.hu/>

European Academy of Sciences in Bologna

<http://www.eurasc.org/>

European Academy of Bolzano/Bozen

<http://www.eurac.edu/en/eurac/welcome/default.html>

<http://www.delprn.ec.europa.eu/?cid=2,176>

Studies in France

<http://www.campusfrance.org/fr/>

Spark educational

<http://www.spark-online.org/content/view/378/1/>

[supporthttp://www.daad.de/deutschland/index.en.html](http://www.daad.de/deutschland/index.en.html)

DISA UNIVERSITETE TË SHQUARA NË BALLKAN

American University Shkup/Skopje <http://www.uacs.edu.mk/>

University of New York - Tirana <http://www2.unyt.edu.al/>

Aristotle University of Thessaloniki

http://www.auth.gr/home/index_en.html

American University in Bulgaria <http://www.aubg.bg/>

UNIVERSITETET E PRISHTINËS

<http://web.uni-pr.edu/> www.aukonline.org/

<http://www.ubt-uni.net/>

<http://www.uiliria.org/>

DISA ADRESA TË TJERA NDIHMËSE PËR STUDIME JASHTË KOSOVËS

http://albanian.pristina.usembassy.gov/educational_exchange.html

<http://www.aacks.org/>

<http://kaef-online.org/>

<http://www.soros.org/grants>

Study in Sweden <http://www.studyinsweden.se/Scholarships/>

Rrjeti internacional për studentë Erasmus ESN

http://eacea.ec.europa.eu/erasmus_mundus/index_en.php

Komisioni Evropian/ Prospekte për edukim

http://ec.europa.eu/education/index_en.htm

Programi austriak për shkollim më të lartë.

<http://www.wus-austria.org/prishtina>

<http://www.masht-gov.net/advCms/#id=1223> - **MASHT**

<https://www.rks-gov.net/sq-AL/Qytetaret/Edukimi/Pages/AsistencatDheBursat.aspx>

<http://aidkosovaalbanian.webs.com/studimedhebursa.htm>

www.scholarship-positions.com

www.universities-in-europe.com

www.munich.euruni.edu

<http://www.kas-ks.org>

<http://www.collegeboard.com/student/index.html?student>

<http://www.educationusa.info/students.php>

<http://www.petersons.com/educationusa.aspx>

<http://colleges.usnews.rankingsandreviews.com/best-colleges>

<http://www.princetonreview.com>

MUNDËSITË për SHKËMBIM (vazhdim i studimeve në një universitet tjetër)

Rrjeti internacional për studentë Erasmus ESN

(http://eacea.ec.europa.eu/erasmus_mundus/index_en.php)

Komisioni Evropian/ Prospekte për edukim

(http://ec.europa.eu/education/index_en.htm)

Programi austriak për shkollim më të lartë.

(<http://www.wus-austria.org/prishtina>)

Një oqean mundësish – shfrytëzojini!

Hapi 5 - 15 minuta :

Tema: Pyetje – Përgjigje - Komente

Objektivi: Dhënia e mundësisë nxënësve për të pyetur dhe sqarimi i ndonjë elementi, i cili nuk është mbuluar gjatë trajnimit si dhe marrja e feedbackut apo një vlerësimi të thjeshtë se sa i dobishëm ka qenë trajnimi.

Profesorët Naim Gashi dhe Majlinda Mazelliu ju dëshirojnë suksese në studime.